

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit qershor, 2025

ETA: 87.5% e Planit të Veprimit Antikorrupsion, i zbatuar në mënyrë të kënaqshme gjatët vitit 2024

10.06.2025: Nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, u zhvillua takimi i parë i vitit 2025 i Ekipit Tematik Antikorrupsion, gjatë të cilit u diskutua dhe u miratua raporti i parë vjetor i monitorimit të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030. Megjithëse strategjia u miratua në dhjetor 2024, institucionet përgjegjëse nisën zbatimin që prej janarit të vitit 2024, duke shënuar një nivel zbatimi në masën 87.5% për Planin e Veprimit. Fokusi kryesor përgjatë vitit 2024 ka qenë parandalimi, përmes analizës së kuadrit ligjor dhe institucional, forcimit të integritetit në administratë dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Bashkëpunimi me sektorin privat është forcuar ndjeshëm, ndërsa në nivel ministror e vendor janë rishikuar, e miratuar plane të integritetit për herë të parë. Në drejtim të ndëshkimit, janë ndërmarrë hapa për forcimin e hetimit administrativ dhe penal, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rikuperimin e aseteve. Ndërgjegjësimi publik është promovuar përmes edicionit të VI-të të Javës së Integritetit dhe projektit “Edukimi kundër korrupsionit” në shkollat e mesme në 6 qytete të vendit. Takimi i Ekipit Tematik Antikorrupsion u ndoq nga të gjitha institucionet zbatuese të strategjisë, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, partnerëve ndërkombëtarë dhe donatorëve.

Raporti i monitorimit mund të aksesohet në link: <https://antikorrupsioni.gov.al/kreu/lista-dokumenteve/>



Ndjekja dhe raportimi i piketave të ndërmjetme, si urë lidhëze e luftës kundër korrupsionit dhe integritetit evropian

26.06.2025: Procesi i integritetit evropian mbetet një angazhim i pandërprerë, që kërkon përparim të qendrueshëm në zbatimin e reformave kyçe. Në këtë kuadër, bashkëpunimi teknik dhe shkëmbimi i informacionit me strukturat e BE-së mbeten thelbësore për të garantuar qëndrueshmërinë e progresit të arritur. Në takimin e muajit qershor 2025 për diskutimin mbi piketat e ndërmjetme me strukturat e Komisionit Evropian, kapitulli i luftës kundër korrupsionit u përqendrua kryesisht në referimet penale të Prokurorisë së Posaçme dhe procesin e kontrollit dhe verifikimit të deklaratave të pasurisë nga zyrtarët publikë. Seksioni i parandalimit të korrupsionit u adresua nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, njëkohësisht Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit, znj. Adea Pirdeni. Në takim morën pjesë dhe ofruan mbështetje ekipi drejtues dhe stafi ekspert i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Ministria Pirdeni informoi mbi ecurinë e fazave përgatitore për paketën e re të ligjeve antikorrupsion, përfshirë: projektligjin për sinjalizimin, aktualisht në proces hartimi me mbështetjen teknike të projektit EU4GG; projektligjin për lobimin, i cili do të hartohet me asistencën e Këshillit të Evropës; projektligjin për donacionet dhe sponsorizimet në administratën publike; ligjin për kontrollin e financimeve të partive politike; si dhe kuadrin ligjor për konfliktin e interesit, tashmë në ndjekje të procedurave parlamentare. Takimi i radhës për vlerësimin e piketave të ndërmjetme është parashikuar të zhvillohet brenda muajit korrik 2025.

Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë në partneritet të rregullt me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit për vitin 2025

12.06.2025: Mbështetja për ndërtimin e instrumenteve antikorrupsion dhe forcimi i kapaciteteve të administratës publike ishin në qendër të diskutimeve në takimin e Komitetit Drejtues të Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë. Takimi u përshëndet nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, e cila vlerësoi bashkëpunimin e vazhdueshëm me këtë institucion, veçanërisht për kontributin në angazhimin e Shqipërisë në proceset e GRECO-s. Ndër arritjet kryesore për 6-mujorin e fundit, u theksua institucionalizimi i kursit “Hyrje në parandalimin e korrupsionit”, i zhvilluar në kuadër të Programit HELP të Këshillit të Evropës dhe i ndjekur nga 80 këshilltarë politikë si edhe koordinatorë antikorrupsion. Ky kurs, i pari i këtij lloji në rajon, synonte të forcojë njohuritë mbi standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas për parandalimin e korrupsionit. Po ashtu, si pjesë e bashkëpunimit, në vijim është iniciuar kryerja e një procesi vlerësimi e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi lobimin, me asistencë të drejtpërdrejtë nga Këshilli i Evropës. Ky vlerësim do të shërbejë si themel për hartimin e një ligji të ri për lobimin, në përputhje me standardet evropiane, duke promovuar transparencë dhe pjesëmarrje të gjerë institucionale dhe shoqërore.



Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit në ndjekje të rasteve për korrupsion në administratën publike

1 - 30.06.2025: Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e hetimit dhe verifikimit administrativ ka vijuar me verifikimin e rasteve (ankesa të ardhura; indicie korrupsioni të marra nga stafi i Drejtorisë së Hetimit dhe ato të Koordinatorëve Antikorrupsion). Gjatë muajit qershor 2025, drejtoria e hetimit ka konkluduar me 6 raporte përfundimtare nëpërmjet të cilëve ka propozuar 16 masa administrative dhe 11 rekomandime për autoritete publike dhe punonjës të tyre, që nuk kanë respektuar kuadrin rregullator në fuqi. Këto masa janë adresuar kryesisht për punonjës të Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetëore të Kadastrës si dhe për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Rekomandimet kanë patur në fokus kryesisht përmirësimin e zbatimit të ligjit, rishikimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator të brendshëm, garantimin e ofrimit të shërbimeve publike brenda afateve ligjore, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe publikun. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit vijon të jetë në komunikim të vazhdueshëm me institucionet përkatëse për të ndjekur nga afër ecurinë e zbatimit të këtyre masave dhe rekomandimeve, duke siguruar një monitorim efektiv dhe mbështetje për përmirësimin e mëtejshëm të proceseve administrative dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.

Shkëmbim rajonal për përmirësimin e mekanizmave të raportimit të korrupsionit

2 - 04.06.2025: Bashkëpunimi rajonal dhe ndarja e eksperiencave në fushën e denoncimit të korrupsionit mblodhi këtë herë në Prishtinë, Kosovë autoritetet antikorrupsion nga rajoni. Takimi u mundësua nga zyrat e PNUD në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe PNUD Korea, dhe shërbeu si një hapësirë diskutimi për prezantimin e platformës online për denoncimin e rasteve të korrupsionit, përfshirë edhe ato të sinjalizimit në administratën publike, e zhvilluar së fundmi në Kosovë me asistencën dhe mbikëqyrjen e Komisionit Antikorrupsion dhe të të Drejtave Civile të Koresë së Jugut. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, u zhvilluan prezantime mbi praktikën parandaluese kundër korrupsionit në vende të ndryshme të rajonit si Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnje dhe Hercegovina dhe Kosova. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit prezantoi progresin e Shqipërisë në forcimin e kuadrit legjislativ dhe institucional si dhe



në avancimin e procesit të integritetit evropian në fushën e luftës kundër korrupsionit. Gjithashtu, mori pjesë në panelin e diskutimit të sesionit 4 të agjendës: “Trendet, çështjet, mundësitë dhe rastet e mira në parandalimin e korrupsionit në Ballkanin Perëndimor”. Drejtoresha e Politikave Antikorrupsion, znj. Rovenia Pregja, mbajti një prezantim të shkurtër mbi masat kryesore të ndërmarra në Shqipëri, duke theksuar rolin e autoriteteve përgjegjëse dhe rëndësinë e forcimit të kuadrit ligjor dhe kapaciteteve institucionale në luftën kundër korrupsionit.



Integriteti në sektorin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor angazhon RESPA-n në pregatitjen e një moduli për rritje kapacitetesh në administratën publike

24 - 26.06.2025: Forumi Rajonal për Integritetin në Sektorin Publik, i cili u zhvillua në Budva, Mali i Zi, mbledhi përfaqësues të lartë të administratave publike dhe agjencive antikorrupsion nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, duke kontribuar në diskutimet mbi standardizimin e integritetit në administratën publike. Në sesionet e punës u trajtuan praktikatat më të mira të vendeve të rajonit dhe përvojat e institucioneve të specializuara nga Franca, ndërsa u prezantua edhe Analiza Rajonale për Integritetin në Sektorin Publik, që identifikon boshllëqet në zbatim, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ndërhyrjet politike. Forumi kulmoi me lançimin zyrtar të Praktikës për Integritetin në Sektorin Publik, një platformë rajonale për bashkëpunim të vazhdueshëm, shkëmbim përvojash dhe ngritje kapacitetesh. Pjesëmarrja aktive e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në këto platforma rajonale forcon angazhimin e Shqipërisë për ndërtimin e një administrate publike të integruar dhe të besueshme, si një komponent kyç i procesit të integritetit evropian. Forumi u ndoq edhe nga staf i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

ASPA në partneritet me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit për të promovuar mekanizmat e integritetit në administratën publike

10.06.2025: Në vijim të masave të parashikuara nga Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030, si dhe në kuadër të bashkërendimit të nismave informuese për luftën kundër korrupsionit, për forcimin e integritetit institucional, Drejtoria e Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim, zhvilluan një trajnim të dedikuar për Koordinatorët e Integritetit dhe Pikat e Kontaktit Antikorrupsion në administratën publike. Trajnimi, i zhvilluar në formatin online, synoi të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve të përfshirë në menaxhimin e mekanizmave të integritetit, përmes prezantimit të instrumenteve konkrete të parandalimit të korrupsionit, zbatimit të standardeve etike dhe promovimit të një kulture institucionale të përgjegjshme dhe të hapur ndaj sinjalizimit të praktikave të pahijshme. Ky format trajnimi përbën një detyrim të qartë nga strategjia antikorrupsion, e cila parashikon ngritjen dhe aftësimin e rrjeteve të brendshme të integritetit në të gjitha institucionet publike. Përfituesit e këtij cikli trajnimi janë pikërisht personat kyç të strukturave të integritetit, që përfaqësojnë nyjet lidhëse ndërmjet institucioneve dhe politikave antikorrupsion.

